



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME
MINISTER/ URED PREMIJERA**
**AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA
RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY**

Klinë, 25 maj 2021

OJQ Zana është përfituese e projektit “**Fuqizimi ekonomik dhe shoqëror i grave nga zonat rurale në fushën e bujqësisë**” financuar nga Agjencia për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit – Republika e Kosovës. Masa 4 Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi, duke targetuar gratë nga zonat rurale të vetë punësuar në sektorin e bujqësisë. Projekti ka për synim të bëjë shpërndarjen e 6 (gjashtë) serave nga 50 metra katrorë.

Të drejtë aplikimi për përfitues të serës kanë të gjitha gratë e komunës së Klinës të cilat si pasojë e pandemisë Covid 19 kanë humbur vendet e punës apo burimet financiar të krijuara nga biznesi i tyre apo angazhimi në një biznes familjar. Përparësi në përfitimin e serave do të kenë gratë të cilat nuk kanë përfituar asnjëherë deri me tani ndihmë qoftë nga institucionet apo nga organizatat e ndryshme, antarët e OJQ “ZANA, rastet sociale, viktimat e luftës, familjarët e dëshmorëve dhe veteranet e luftës.

Gratë e interesuara për të përfituar nga ky projekt duhet të plotësojnë aplikacionin të cilin mund ta sigurojnë në zyrat e OJQ Zana në Klinë, “Rruga Abedin Rexha pn: Kline ose duke dërguar kërkesë përmes emailit Info@ngo-zana.org.

Për të u kualifikuar për të qenë njëra nga përfitueset e serës, fillimisht aplikueset duhet të ndjekin trajnimin e ofruar nga OJQ Zana.

Aplikacioni i plotësuar bashkë me fotokopjen e letërnjoftimit dhe dokumentet tjera të nevojshme duhet të dorëzohen në zyrat e OJQ Zana në Klinë deri të premten me 31 maj 2021.